

## **BULETINI I IGJK maj 2004**

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me qështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë. IGJK në këtë vit do të ftojë gjyqësinë që të kontribuojnë në këtë buletin dhe të publikojnë artikujt apo raportet e tyre.

### **RAPORTI PËRMBLEDHËS I SEMINARIT PËR TRAFIKIM ME QËNIE NJERËZORE**

Instituti gjyqësor i Kosovës më 14 dhe 15 prill 2004, ka mbajtur një seminar dyditor rreth trafikimit me qenie njerëzore. Ky seminar është organizuar duke iu falenderuar mbështetjes së ekspertëve të specializuar të cilët punojnë për organizata dhe institucione të cilat kanë një eksperiencë të dëshmuar rreth kësajë qështje dhe të cilët rregullisht merren me qështjet apo rastet e trafikimit.

Agjenda e seminarit është bërë në përputhshmëri me modulën e trajnimit për anitrafikim, të zhvilluar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën jug-lindore për gjyqtarët dhe prokurorët, brenda kornizës së programit gjithpërfshirës trajnues, shkëmbimi dhe bashkëpunimi i pushtetit të paktit të stabilitetit për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Gjithnjë e më shumë ekziston një vetëdije se veprimi efektiv kundër trafikimit kërkon një qasje të koordinuar multidisiplinare në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar që duhet të përfshijë akterët kryesor ku përfshihen edhe gjyqtarët dhe prokurorët.

Qëllimi i këtij raporti është që të përmbledh temat që ishin prezentuar nga ekspertët gjatë këtij seminari, në mënyrë që informojë dhe të ngrisë mundësinë e gjyqësisë për të kuptuar dukurinë e trafikimit të qenieve njerëzore si një shkelje e të drjtave të njeriut dhe një vepër penale.

Ekspertët vendor dhe ndërkombëtar mbajtën prezentime të rëndësishme për pjesmarrësit rreth dukurisë së trafikimit me qenjet njerëzore, zhvillimin dhe përparimin e ligjeve ndërkombëtare të ndërlidhura me këtë qështje, elementet kryesore të trafikimit dhe fazat e procesit të trafikimit, legjislacioni i aplikueshëm rreth trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë dhe implementimi i tij, mekanizmat për luftimin e trafikimit në Kosovë, trauma dhe nevojat e viktimës, teknikat e posaqme të hetimeve dhe aspektet specifike të procedurave penale në rastet e trafikimit, gjithashtu edhe mbrojtja dhe ndihma e viktimave gjatë ndjekjes dhe në gjykime.

Shpresojmë se ky raport do të kontribojë dhe ndikojë te gjyqtarët e posaqërishtë te ata që nuk kanë marrë pjesë në këtë seminar të trafikimit të qënieve njerëzore, është kjo një dukuri që na preokupon shumë edhe në Kosovë. Sidoqoftë, gjyqtarët dhe prokurorët që ishin present paraqitën shumë brenga që ata do të kishin pasur dëshirë që të rregullohen sa më shpejt.

## **I. Trafikimi me qenje njerëzore: pasqyrim i përgjithshëm dhe situatë në Kosovë**

### 1. pasqyrim i përgjithshëm

Në dhjetë vitet e fundit kemi parë një rritje të madhe të trafikimit me qeniet njerëzore, që është bërë përmes dhe nga Evropa juglindore. Kjo dukuri ka arritur dimensione alarmuese më së shumti në Ballkan dhe në shtetet fqinjë. Departamenti i SHBA-ve në qershor të vitit 2003 ka vlerësuar se 800 000 deri në 2 000 000 gra dhe fëmijë trafikohen përtej kufijve ndërkombëtar çdo vit. Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) vlerëson se në Evropë 500 000 gra detyrohen më dhunë të punojnë në prostitucion. Kjo përbënë një shkelje të rëndë të drejtave të njeriut dhe posaqërisht sfidon policinë dhe gjyqësinë.

Trafikimi me qenie njerëzore është një biznes kriminal global që bazohet në shfrytëzimin, e tërhequr nga kërkesa dhe oferta. Qarkullimi vjetor për trafikim sillet diku rreth 7 – 8 miliardë dollarë. Trafikimi nuk rezulton vetëm me shfrytëzim seksual, mirëpo edhe me

donimin e organeve trupore, punë të detyruar, robëri të dhunshme, apo praktika të ngjajshme me skllavëri, kërkimin e lëmshës, vjedhjes dhe punës shtëpiake.

Arsyerat e përgjithshme të trafikimit më së shumti janë ato ekonomike, pasi që individët kërkojnë raste më të mira për shkak të varfërisë, konflikteve, luftërave, ndjekjes, dhunës dhe këta persona mashtrohen me premtime të rrejshme dhe joshen nga premtimet e pagesës së lartë. Gjithashu shkaqe të kësaj mund të jenë edhe mungesa e legjislacionit, korrupcioni, dhe diskriminimi gjinor. Trafikimi prek të dy gjinitë atë femrore dhe mashkullore mirëpo femrat janë të prekura në mënyra më të ndryshme se sa mashkujt rreth asajë se si përfundojnë ato dhe vuajtjes dhe pasojave që u mbesin aryre. Tradicionalisht femrat kanë pasur më pak qasje në edukim dhe në punët profesionale. Në të njejtën kohë dobësimi i shoqërisë tradicionale ka qar deri te rritja e numrit të grave që duhet ose kanë përgjegjësinë për mbajtjen e familjes dhe kjo bëhet nga gratë duke kërkuar migrim. Sidoqoftë edhe pse në ditët e sotme shumica e emigrantëve në tërë botën janë femra politika e emigracionit dhe mundësitë janë ende të orientuara kah meshkujt. Emigrantët femra kanë më pak gjasa që të kenë qasje në tregun e punësimit dhe në detyrimet e emigrimit. Gratë kanë më shumë gjasa që të emigrojnë në sektoret ose vendet e pa zhvilluara dhe të pa rregulluara, posaqërisht të punë shtëpiake dhe industrinë e seksit. Këto janë dy sektore që kanë nuk kanë fare

apo kanë mbrojtje minimale dhe që shpesh nuk konsiderohen as si punë. Për shkak të natyrës së punës dhe formave të migrimit në të cilat ato mund të kenë qasje femrat ndërlidhen me agjencione të dyshimta dhe njerëz të moshës së mesme, dhe kështu ato janë më të përshtatshme për trafikim dhe për forma tjera të keqpërdorimit. Edhe një faktor tjetër është se si prostitutat mbulohen me turp nga qëndrimi jonjerëzor që nënkupton se pasi që një grua të është bërë prostitutë ajo më nuk meriton të njejtën mbrojtje kundër dhunës dhe keqpërdorimit sikurse qytetarët e tjerë. Ky qëndrim qëllimisht shfrytëzohet nga trafikuesit.

Rekrutimi bëhet në mënyra shumë të thjeshta përmes shokëve, anëtarëve të familjes apo të njohurve (dikë që e njohin qysh moti) dhe gjithashtu përmes agjencioneve të ndryshme. Trafikantët përfitojnë nga rasti që të rekrutojnë gratë që marini iniciativa për tu larguar nga varfëria dhe papunësia dhe shpeshë herë kanë familjet që mvaren nga paga e tyre procesi i trafikimit nuk ndalohet kur personat e trafikuar lirohen apo ikin nga situatat shtrënguese. Edhe pasi të jetë kryer situata e trafikimit personat e trafikuar ballafaqohen me probleme të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe problemet shëndetsore, fizike dhe psikologjike. Në të shumtën e rasteve trafikantët e dinë se ku jeton viktima kështu që ikja nuk i përfundon të gjitha problemet, kërcënimet dhe ndëshkimet ndaj viktimës dhe familjes së saj.

## 2. Situata në Kosovë

Viktimat e trafikimit mund të jenë femra dhe meshkuj, të rriturit dhe fëmijët. Në Kosovë femrat janë më së shumti të trafikuar kryesisht për shfrytëzim seksual apo prostitucion të detyruar. Gra nga Moldavia (58 %), Romania, Ukraina, Bullgaria, Shqipëria dhe Rusia detyrohen në prostitucion. Femrat gjithashtu trafikohen edhe brenda teritorit të Kosovës. Në të vërtetë Kosova jo vetëm që përbënë një vend transit por edhe vend të burimit dhe të destinacionit të trafikimit. IOM-I tashmë ka siguruar ndihmë për 29 femrat e para Kosovare të trafikuar brenda Kosovës dhe jashtë që kanë qenë të detyruara në prostitucion. Sidoqoftë, IOM-I ka asistuar 409 viktima që kanë qenë të trafikuar në Kosovë që nga shkurti i vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2003. Në 83% të rasteve personat e trafikuar kishin qenë duke kërkuar kushte më të mira për jetesë jashtë vendit pasi që ato ishin paguar me pak se 30 Euro në muaj në vendin e tyre. Shumica e punëve të premtuara kishin qenë në Itali. Viktimat ishin nga të gjitha moshat; mesatarja ishte 22 vite. Në shumicën e rasteve (75%) viktimat kishin një të kaluar profesionale dhe përvojë të mëparme në sektore të ndryshme në vendet e tyre dhe jashtë. Nga këto 409 viktima 29 prej tyre ishin nga Kosova. Kjo na ka treguar se në të vërtetë Kosova po bëhet vendi i origjinës. Një përqindje e lartë nga këto viktima ishin të mitura nga rajonet rurale. Ministria e punëve sociale ka themeluar një program reintegrues për keto viktima.

Kosova ofron një numër të faktorëve shumë të favorshëm për trafikim për shkak të pozitës gjeografike, afërsisë me shtetet e Evropës lindore, situatës së pasluftës, prezencën e lartë të komunitetit ndërkombëtar, kufirit të thyeshëm, kontrollit të kufizuar kufitar, ligjeve të reja të posanxjerrura të antitrafikimit, korridoreve të themeluara të kontrabandimit dhe korrupsionit. Korridoret kryesore në Kosovë me sa duket janë në veri nga Serbia dhe përmes Maqedonisë.

## **II. Qasjet e legjislacionit dhe politikave vendore dhe ndërkombëtare në përgjegjjen kundër trafikimit.**

Përgjegjjet e tanishme të legjislacionit dhe politikave bazohen në një qasje me tri shtylla: parandalimi i akteve të trafikimit, ndjekja e kryesve dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit.

### **1. Parandalimi i trafikimit**

Në nivelet vendore dhe ndërkombëtare janë ndërmarrë shumë iniciativa për të parandaluar dhe për të luftuar trafikimin.

#### **a- Ato në nivelin ndërkombëtar**

Para vitit 2000 nuk ka pasur asnjë definicion të trafikimit të njohur ndërkombëtarisht, edhe pse përgjithësisht ka qenë e njohur si shkelje shumë serioze e të drejtave të njeriut. Të gjitha shtetet kanë pasur definicionet e tyre të trafikimit që ka paraqitur problem në adresimin e drejtë të kësajë qështje në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe

identifikimin e drejtë të viktimave. Sidoqoftë së voni shtetet kanë filluar të ndërlidhin trafikimin me qështjet kryesore të sigurisë duke përfshirë këtu edhe kontrabandimin e emigrantëve dhe krimin e organizuar.

Në nëntor të vitit 2000, Asembleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka miratuar tri instrumente të formuara për të themeluar bazën për një instrument ndërkombëtar ligjor për të luftuar krimin e organizuar ndërkombëtar: Konventa kundër Krimin të Organizuar Transnacional, e plotësuar me dy traktate (protokolle) shtesë, që merren kryesishtë me trafikimin e personave, posaqërishtë grave dhe fëmijëve dhe me kontrabandimin e emigrantëve. Këto tri Traktate janë hapur për nënshkrim në Palermo të Italisë në dhjetor të vitit 2000 dhe pas numrit të nënshkrimeve të kërkuara për miratim, hyri në fuqi më 29 shtator 2003, 25 dhjetor 2003 dhe 278 janar 2004. Të gjitha shtetet e Evropës Jug-lindore kanë miratuar këto Traktate.

Protokolli për të parandaluar, ndjekur dhe dënuar trafikimin në njerëz, posaqërisht në gra dhe fëmijë (protokolli mbi trafikimin) themelon definicionin e parë të përbashkët ndërkombëtar të "trafikimit në njerëz" dhe është instrumenti i parë i detyrueshëm ligjor ndërkombëtar i cili hollësisht adreson masat parandaluese të anti-trafikimit dhe veprimet në fushën e mbrojtjes si dhe assistencën ndaj personave të trafikuar. Është kryesisht një instrument për zbatuesit e ligjit me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit

ndërkombëtar dhe obligon shtetet anëtare të ndjekin penalisht trafikimin, trafikuesit, ekstadojnë të dyshimtit dhe të japin informata. Protokollin përmbanë një definicion të gjërë të trafikuesve duke përfshirë të gjitha format e trafikimit për qëllim të shfrytëzimit seksual, punës së detyruar, robërisë, praktikave të ngjajshme me robërinë dhe skllavërimi. Ky protokoll sidonftë lejon një liri veprimi të shtetet sa i përket implementimit të dispozitave të saj, mbrojtjes dhe assistimit të personave të trafikuar. Termet shfrytëzim dhe shfrytëzim seksual nuk janë definuar në Protokoll që do të thotë se se ky traktat është pa paragjykim rreth asajë se si shtetet anëtare do të adresojnë prostitucionin në ligjet e tyre përkatëse vendore.

Sidonftë Protokollin ka arritur që të sigurojë për shtetet me një definicion duke lejuar që të bëhet një interpretim më i gjërë, kjo është bërë për shkak të ndërlidhshmërisë së kësajë qështje. Definicioni përbëhet nga tri pjesë: veprimet, mjetet dhe qëllimet. Ky definicion përfshinë të gjitha format e trafikimit dhe nuk e kufizon qështjen në prostitucion dhe robëri, dhe nuk koncentrohet vetëm në grad he vajza, mirëpo definon se femrat, meshkujt vajzat dhe djelmoshat të gjithë mund të jenë viktima të trafikimit. Trafiku definohet në përdorimin e shtrëngimit apo mashtrimit dhe jo si lloj pune. Protokollin gjithashtu bën dakkime në mes të të rriturve dhe fëmijëve, në kuptimin se në rastin kur janë përfshirë fëmijët nuk ka nevojë të ketë shtrëngim apo mashtrim pasi që statusi i fëmijut

dhe fakti se ata janë më të përshtatshëm për një gjë të tillë i pamundëson ata që të jenë të përgjegjshëm sikurse do t'i bënte ata po të kishin qenë të rritur. Protokollin nuk kërkon që viktima të kaloj kufijtë e njohur ndërkomtarishtë, duke marrë para sysh se personat gjithashtu trafikohen nga një rajon në tjetrin edhe brenda një shteti.

Protokollin gjithashtu formon një definicion të qartë në mes të dukurisë së trafikimit dhe të kontrabandimit të emigrantëve. Kontrabandimi i emigrantëve është një krim kundër rendit dhe qetësisë publike që rregullon qështjen e hyrjes ligjore në atë shtet, pa ndonjë viktimë specifike; përderisa trafikimi është një krim kundër një personi dhe shkelje e të drejtave të njeriut. Kështu pra kontrabandimi merret me mbrojtjen e kufijve, dhe qëllimi i tij nuk është që të shfrytëzoj personin por që të rregulloj qështjen e hyrjes dhe qëndrimit të paligjshëm. Fatkeqësisht shumë persona të trafikuar që hyjnë në shtet në mënyrë të paligjshme deportohen pa u identifikuar si viktima të dhunës, kështu që të drejtat e tyre për siguri dhe mbështetje shelen nga institucionet që kanë përgjegjësinë për të mbrojtur ato viktima dhe për të dënuar ata që kanë keqtrajtuar dhe shfrytëzuar ato.

## **b- në nivel vendor**

Në Kosovë në nivelin vendor është themeluar sistemi referees. Një grup për luftimin e trafikimit, assistimin direct, dhe një grup që bënë kordinimin përbëhet nga Organizata

Ndërkombëtare për Migrim (IOM) Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Departamenti i Drejtësisë /VAAU (njësi për mbrojtjen dhe asistimin e viktimave), Organizata për parandalimin e trafikimit dhe parandalimin e trafikimit me qënie njerëzore (PVPT), Njësia Policore për hetimin e trafikimit (TPIU) dhe në baza ad-hoc Departamenti i Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe fëmijëve (QMGF), janë përgjegjëse për asistimin e grave të trafikuar në Kosovë dhe formohet një forum për diskutime të rasteve individuale dhe kërkesave të përfituesve. Ky grup i brendshëm i trafikimit të personave ka miratuar procedurat e përbashkëta standarde të veprimit për asistimin e viktimave (SOP) për të siguruar që të gjitha fushat e programit janë të mbuluara dhe që të kordinojë mirë të gjitha aktivitetet. Këto procedura përshkruajnë procedurën që duhet ndërmarrë gjatë asistimit të një viktime të trafikut që nga pika e identifikimit deri në momentin e strehimit të saj. Këtu gjithashtu përshkruhet sistemi referees për organizatat e përfshira dhe kjo procedurë plotësohet dhe rishqyrtohet çdo gjashtë muaj apo kur të paraqitet ndonjë nevojë.

TPIU bënë hetimet për të identifikuar trafikantët: kur egziston dyshimi i arsyeshëm që një ose disa persona janë të përfshirë në trafikim, ata kryejnë hetimet, bëjnë kontaktet e para me femrat dhe vajzat gjatë fushatës së tyre

dhe arrestojnë dhe paraburgosin trafikuesit e dyshimtë, Kur dyshojnë se janë duke mbajtur një person të trafikuar TPIU merr deklaratën nga këto femra pastaj thirren kryesuesit rajonal të trafikimit nga OSBE për të intervistuar viktimën. OSBE do të tërhiqet kur këto kompetenca do të transferohen te njësitë për asistimin e viktimave në departamentin e drejtësisë. OSBE do të përcaktojë se a do të referohet rasti në IOM për asistencë në riatdhesim apo do të kontaktohet një strehimore për të pranuar këta persona. TPIU bënë marrëveshje drejtpërsëdrejti me IOM dhe stehimoren që udhëhiqet nga PVPT apo me qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve. Pasi që viktimat të jetë strehuar atëherë IOM-I vazhdon me një intervistë të gjërë dhe fillon dhe kryen procedurën e kthimit apo reintegrimin. Në Kosovë egzistojnë katër strehimore. Strehimorja e menagjuar nga PVPT merret me viktimat ndërkombëtare dhe iu siguron atyre mbrojtje deri sa ato të riatdhesohen (prej tri javë deri në tre muaj). Kjo strehimore është përgjegjëse për të siguruar nevojat themelore të viktimave duke përfshirë edhe kujdesin themelor mjekësor, këshillimin mjekësor dhe trajnimin profesional. Për shkak të rrezikut që viktimat do të mund të identifikonin lokacionin dhe të rrezikonin integritetin e strahimores kjo strehimore në parim nuk pranon viktimat të trafikimit të brendshëm.

(Pjesa e dytë e këtij artikulli do të publikohet në buletin e ardhshëm)

*Znj. Sylvie Nicole, Koordinatore  
ndërkombëtare e Programit në IGJK*

## **Programi i Aktiviteteve për muajin Maj 2004**

- Seminar mbi Pasqyrimin e Forenzikës dhe rast shqyrtimet në lidhje me Sulmet Seksuale
- Seminar mbi Mbrojtjen kundër Dhunës Familjare
- Seminar mbi Veprat Kundërvajtse
- Seminar mbi Paverësin e Gjyqësis
- Seminar mbi Ligjin Penal të Kosovës për të Mitur
- Seminar mbi të Drejtat Pronësore
- Kursi fillestar

### Seminar mbi Pasqyrimin e Forenzikës dhe rast shqyrtimet në lidhje me Sulmet Seksuale

Instituti Gjyqësor i Kosovës, së bashku me zyrën e SHBA Departamenti i Drejtësis në Prishtinë/Pristina, do të organizojn seminarin mbi pasqyrimin e forenzikës dhe rast shqyrtimet në lidhje me sulmet seksuale i cili do të mbahet me 4. dhe 6 Maj 2004. kjo çështje është shumë e rëndësishme për arsye se veprat penale kundër integritetit seksual janë të inkuorporuara në Kodin ri Penal të Përkoshëm të Kosovës. Në temat e këtij seminari do të përqendrohemi kryesisht në efektet e sulmeve seksuale për komunitetin, dokumentacionet e vend ngjarjes së këtyre veprave, teknikat gërshetuese dhe forenzika. Rast shqyrtimi do të jetë bazuar sipas dispozitave të Kodit të ri Penal të cilat do të jenë pjesë e diskutimeve gjithashtu. Ekspertet të cilet do të kontribuojn në këtë seminar janë Asistenti Special i Krye-Prokurorit të Shtetit, Patologu Ekzaminues në lidhje me Sulmet Seksuale, dhe Kordinatori Edukimi të Koalicionit kundër Sulmeve Seksuale, të gjithë këta ekspert vin nga Mississippi, si dhe Kshtilltari Ligjor Shtetror nga SHBA është njëri nga këta ekspert. Gjyqtarët dhe Prokurorët penalista janë të ftuar të marrin pjesë në këtë seksion.

### Seminar mbi Mbrojtjen kundër Dhunës Familjare

IGJK-ja do të ofroj një seminar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/12 Mbrojtja kundër Dhunës Familjare i cili do të mbahet me 5, Maj 2004 diskutimet janë të lidhura ne atë pas një viti që kjo Rregullore ka filluar të aplikohet. Antarët e gjyqësis kanë shprehur interes të madh në lidhje me këtë çështje për arsye se sipas kësaj Rregullore janë themeluar procedura civile si edhe ajo penale në lidhje me këtë çështje. Sidoçoft, gjyqtarët të cilet punojnë në lamin civile dhe penale si dhe prokurorët publik të cilet nuk kanë marrur pjesë në seminarin e mbajtur me 4 dhe 5 Nëntor 2003 do të jenë të ftuar në këtë seksion. Ky program është i adresuar përgjegjësis Gjykatave të cilat kanë kompetencat mbi këto raste. Në agjend përfshihen temat vijuese: rëndësia e

Rrregullores 2003/12, krahasimi i legjislacionit Evropian dhe SHBA si dhe praktika gjyqësore, procedura sipas kësaj Rrregullore dhe llojet e urdhërave mbrojtse, veprat penale nga dhuna familjare, përgjegjësia, kompetencat e Gjykatave dhe ndëshkimet. Ekspertet të cilet do të kontribuojn për këtë seminar janë gjyqtarë vendor dhe ndërkombëtar, një gjyqtarë nga Gjykata e Qarkut Prishtinë/Pristina, një avokat nga Prizreni/Prizren, Trajnues Gjyqësor nga IGJK-ja dhe kshilltar Ligjor Shtetror nga departamenti i Drejtësis SHBA. Diskutimet rreth implementimit të kësaj Rregullore do të zhvillohet sipas prezences së pjesëmarrësve të cilet do të prezantojnë rastet të cilët i kanë shqyrtuar gjatë një viti dhe gjithasht vështirësit praktike që janë ballafaquar në aplikimin e kësaj Rregullore.

### Seminar mbi Veprat Kundërvajtse

IGJK-ja do të organizoj edhe një seminar me datën 13 Maj 2004 në lidhje me aftësimin e programeve të edukimit ligjor për gjyqëtarët të cilet punojnë në lamin kundërvajtse dhe në Gjykatat për Kundërvajtje të Kosovës. Në këtë seminar do të përqendrohemi kryesisht në temat procedurale dhe ligjore të kësaj çështje për të cilën Gjykatat për kundërvajtje janë kompetente, komunikacioni rrugor, mbajtja e rendit dhe qetësis. Tre gjyqtarë nga Gjykata e lartë për kundërvajtje do të jenë trajnues dhe folës të këtij seminari. Ky seminar është seksioni i dytë organizuar për këtë vit dhe 25 gjyqëtarë të gjykatave për kundërvajtje janë të ftuar në këtë seminar.

### Seminar mbi Pavarësin e Gjyqësis

Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Kshillin Evropian do të organizojn një seminar i cili do të mbahet me 14 Maj 2004, në Grand Hotel seminar mbi Pavarësin e Gjyqësis. Ky seksion trajnimi do të fokusohet në disa tema. Tema e parë ka të bëjë me Gjyqësin si “fuqi e tretë” për ndërtim të një shteti demokratik: Korniza Kushtetuse, definicionet e përcaktimit të fuqisë së tretë dhe sistemet e organizatave të cilat veprojnë në Kosovë (standardet dhe rekomandimet nga Kshilli Evropian do të prezantohen dhe do të bëhet krahasimi dispozitave/rrregulloreve nga këto organizata, roli dhe emërtimi i Gjyqësis në Kosovë). Prezantime të tjera do të jenë në lidhje me pavarësin dhe mbikqyrjen e gjyqtarëve; ndërhyrje politike të fuqisë ekzekutive në lidhje me pavarësin gjyqtarëve, mënyra e selektimit dhe promovimit të gjyqtarëve pavarësisht e gjyqtarëve të Kosovës. Ekspertet të cilet do të kontribuojn këtij seminari janë një gjyqtarë vendor, një ekspert nga Kshilli Evropian, një gjyqtarë Gjerman, dhe moderator të këtij seminari do të jenë një gjyqtarë nga shoqata e gjyqtarëve dhe një trajnues Gjyqësor nga IGJK-ja. Ky seksion trajnues ju adresohet të gjithë gjyqtarëve të Kosovës.

### Seminar mbi Ligjin Penal të Kosovës për të Mitur

Nxjerrja e Rregullores së UNMIK-ut 2004/8 mbi Ligjin Penal të Kosovës për të Mitur është aprovuar dhe ka hyr në fuqi në të njëjten ditë me 20 prill 2004, në këtë rast IGJK-ja do të organizoj një seminar ad-hok përkritazi me këtë temë me datë 19 maj 2004. Ky seksion trajnimi ju adresohet gjyqtarëve të Gjykatave Komunale kompetente në këtë



çështje. Kjo temë ka të bëjë me masat e aplikueshme, ndëshkimet, dhe procedurën e paraparë me Ligjin Penal të Kosovës për të Mitur, ekzekutimi i masave edukuese dhe gjykimi i të rriturve për kryerjen e veprave penale të kryera kundër të miturve. Ekspertet të cilet do të kontribuojn për këtë seminar do të jenë ekspert vendor të cilet punojnë me çështje penale, një gjyqtarë nga Gjykata e Qarkut Mitrovicë/Mitrovica dhe dy gjyqtarë nga Gjykata Supreme e Kosovës.

### Seminar mbi të Drejtat Pronësore

Instituti Gjyqësor i Kosovës, në bashkëpunim me Kshillin Evropian, do të organizojn një seminar me datën 21 Maj për gjyqtarët të cilet punojn me çështjet civile. Këto tema kryesisht do të prezantohen në lidhje me kompetencat Gjykatave të Rregullta, Drejtorati mbi Çështjet Banësore - Pronësore dhe komisionit për Kërkesat Banësore – Pronësore. Qendra Kryesore e Procesit Ligjor të Drejtoratit mbi çështjet Banësore – Pronësore, një gjyqtarë nga Gjykata Komunale Prishtinë/Pristina, dhe një ekspert nga Kshilli Evropian do të jenë eksperte të cilet kontribuojn për këtë seminar.

### Kursi fillestar

IGJK-ja do të mbaj kursin fillestar për 43 prokurorë të rinjë të cilet janë rekomanduar për postet e prokurorve, ky seminar do të fillon me datën 24 deri me 27 Maj 2004. kandidatet do të trajnohen kryesisht me temat e Kodit të Ri Penal të Përkohshëm të Kosovës dhe ati të Procedurës Penale. Temat të tjera do të jenë nga çështja e forenzikes, të të Drejtat e Njeriut, si edhe tema e etikës do të prezantohet për pjesëmarrësit e këtij seminari.